

## STATUTI

I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Glekost” Sh.p.k

### KREU I

NENI 1

### EMERTIMI I SHOQERISE

1.1. Shoqeria mban emrin “Glekost” sh.p.k dhe eshte person juridik shqiptar.

1.2. Kjo shoqeri e fiton statusin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

1.3. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontrata respektive.

NENI 2

### FORMA LIGJORE E SHOQERISE

2.1 Shoqeria Tregtare “Glekost” sh.p.k eshte person juridik shqiptar, i organizuar ligjërisht si një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, ne përputhje me ligjet e Shqiperise dhe dispozitat e statutit aktual apo atyre qe do vijojnë.

NENI 3

### SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqerise tregtare “Glekost” sh.p.k do kete seline ne adresen, Tac Qender, njesia administrative Qender, Erseke, me Nr.pasurie 708/26, Zona Kadastrale 3558, Shqiperi, dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

3.2. Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

## NENI 4

### KOHEZGJATJA

**4.1.** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.R.

## KREU II

### NENI 5

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

**5.1.** Objekti i aktiviteteve te Shoqerise eshte si me poshte :

- Veprimtari ne fushen e bujqesise, blegtorise, pemtarise. Tregtimi, perpunimi, eksporti, importi i prodhimeve bujqesore, blegtorale te paperpunuara dhe te perpunuara dhe imputeve dhe makinerive bujqesore te te gjitha llojeve;
- Veprimtari ne sektorin e agroindustrise. Perpunimi paraprak dhe perfundimtar i produkteve te ndryshme bujqesore, blegtorale dhe frutore; tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve teknologjike, makinerive, laboratoreve te cilesise dhe pajisjeve te tjera, qe drejperdrejt ose terthorazi lidhen me sektorin e agroindustrise;
- Veprimtari ne fushen e transportit kombetar dhe nderkombetar te mallrave;
- Veprimtari ne fushen e mjedisit dhe agroturizmit;
- Veprimtari ne fushen e ndertimit, montimit te impianteve te perpunimit te prodhimeve bujqesore, blegtorale, etj;
- Veprimtari ne fushen e marketingut te prodhimeve agroindustriale, bujqesore, blegtorale, mjedisore, ndertimit, makinerive, pajisjeve, etj., te lidhura drejperdrejt ose terthorazi me agroindustrine, mjedisin, transportin, etj;
- Veprimtari financiare ne fushen e mbeshtetjes se bashkepunimit te fermereve, kooperativave bujqesore dhe organizmave te tjera vendase dhe nderkombetare te lidhura drejperdrejt ose terthorazi me sektoret e agroindustrise, agroturizmit, mjedisit, etj;

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund:

- I. Te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara sit e dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me lart;
- II. Te bleje ne menyre direkte apo indirekte, kuota te shoqerive te tjera qe kane nje objekt te perafert me ate te Shoqerise, ne Shqiperi ose jashte shtetit;
- III. Te kryeje cdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet I dobishem ose I domosdoshem per te arritur qellimin e aktivitetit te saj.

### **KREU III**

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

**6.1** Kapitali themeltar i shoqerise “**Glekost**” sh.p.k eshte i barabarte me vleren 1 000 (njemije) leke dhe eshte i ndare ne 2 kuota. Ortaket e Shoqerise dhe kuotat perkatese te tyre jane si me poshte:

- **Glen Struga**, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlore nominale 500 (peseqind) leke, qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te shoqerise;
- **Kostandinos Hasula**, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlore nominale 500 (peseqind) leke, qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te shoqerise;

**6.2** Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

#### **NENI 7**

#### **ZVOGELIMI DHE ZMADHIMI I KAPITALIT**

**7.1** Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit te Shoqerise mund te kryhet me vendim te asamblesë, ne cdo kohe dhe me shume se nje here, përmes kontributeve ne para apo ne natyre, ne zbatim te ligjeve ne fuqi, ne momentin e zmadhimit ose zvogëlimit te kapitalit dhe këtij statuti.

**7.2** Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise mund te kryhet me vendim te asamblesë, ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe te statutit. Ne cdo rast, kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogëlohet përtej minimumt te parashikuar ne ligj.

**7.3** Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise përballohet nga secili prej ortakeve ne përpjesëtim me kuotat qe ka ne kapitalin e Shoqerise.

#### **NENI 8**

#### **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**8.1.** Kuotat, jane te transferueshme mes ortakeve dhe tek te tretet. Transferimi i kuotave apo mes ortakeve dhe ne favor te te treteve, kryhet gjithnjë pas miratimit unanim te te gjithe ortakeve dhe me akt notarial te posacem.

**8.2.** Nese nje nga ortaket deshiron te shese kuotat e tij ai duhet te respektoje te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te kesaj shoqerie.

**8.3.** Kuotat e kapitalit të shoqerise dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**8.4.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**8.5.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

#### **KREU IV**

#### **NENI 9**

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

**9.1.** Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**9.2.** Asambleja e Pergjithshme, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

**9.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme duhet te regjistrohen në librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**9.4.** Asambleja e Pergjithshme, ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Nese asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te cilesuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo me mjete elektronike, ne perputhje me piken 3, te nenit 88, te ketij ligji.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendor me siper, ajo duhet te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

**9.5.** Asambleja e Pergjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin ose prishjen e shoqerise.

Per te gjitha ceshtjet e tjera te percaktuara ne neni 81, te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", asambleja vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

**9.6.** Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret sipas rregullave te parashikuara ne nenin 82 e vijues te ligjit te mesiperm.

## **KREU V**

### **NENI 10**

#### **ADMINISTRATORI**

**10.1.** Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Glen Struga**, lindur me date 04.06.1992 ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqipater, i identifikuar me ane te Pasaportes me Nr. J20604067J.

**10.2.** Kohezgjatja e qendrimit ne detyre te Administratorit eshte per nje afat 5 (pese) vjecar, me te drejte riperteritur te ketij mandati.

**10.3.** Administratori emerohet dhe shkarkohet, ne çdo kohe, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

**10.4.** Administratori vepron ne lidhje me cdo çështje te Shoqerise qe nuk eshte caktuar nen autoritetin e Ortakeve ne përputhje me kete Statut, dhe cdo apo te gjithë vendimeve te Ortakeve si dhe ligjeve te zbatueshme.

### **NENI 11**

#### **KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

**11.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rrethanat, që kërcenojnë

mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;  
dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;  
e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

**11.2.** Administratori eshte i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe ne rastet kur:

- *sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.*

**11.3.** Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**11.4.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

**11.5.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjafthueshme.

## KREU VI

### NENI 12

#### VITI FINANCIAR

**12.1.** Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

## NENI 13

### BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

**13.1.**Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

**13.2.**Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 14

### MBARIMI I SHOQERISE

**14.1.**Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të Asamblese se Pergjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

**14.2.**Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej saj emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

**14.3.**Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**14.4.**Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Pergjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## NENI 15

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

**15.1.**Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakeve te shoqerise ose kur

ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur Asamblese nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

**15.2.** Çdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

## **KREU VII**

### **TE NDRYSHME**

#### **NENI 16**

#### **PERGJEGJESIA E ORTAKEVE**

**16.1.** Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakeve.

**16.2.** Ortaku qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte perqejes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk perqigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

#### **NENI 17**

#### **SIMBOLET E SHOQERISE**

**17.1.** Shoqeria do te kete vulen e saj ku do te shkruhet emertimi i shoqerise.

#### **NENI 18**

#### **BAZA LIGJORE**

**18.1.** Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

**18.2.** Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 19**

**MOSMARREVESHJET**

**19.1.** Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

**19.2.** Ne rast te kundert per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jetë Palet do ti drejtohen Gjykates.

**NENI 20**

**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlera te njejtë juridike.

**ORTAKET:**

Glen STRUGA



Kostandinos HASULA



D2. 10/09/2020